

VENDIM
Nr.619, datë 7.9.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000.”.

b) Paragrafi i parë i pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që janë bërë të tillë për shkaqe që lidhen me punësimin, është 6 800 (gjashtë mijë e tetëqind) lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që ata përfitojnë nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për pagesën e paaftësisë, për vitin 2006, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha